



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
BORDI**

VENDIM

Nr. 54, Datë 26.03.2020

MBI

**NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN E BORDIT TË ERE-S, NR. 141, DATË 24.09.2019 MBI
LICENCIMIN E SHOQËRISË “AYEN AS ENERGJI” SH.A., NË VEPRIMTARINË E
TREGTIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE.**

Në mbështetje të nenit 16 të Ligjit nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, i ndryshuar; nenit 113 të Ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative, nenit 15 të “Rregullores së organizimit, funksionimit dhe procedurave e ERE-s”, miratuar me vendimin e bordit të ERE nr. 96 datë 17.06.2016, Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 26.03.2020, mbasi shqyrtoi relacionin e Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikqyrjes, mbi shfuqizimin e pjesës së pikës 2, të vendimit të bordit të ERE-s nr. 142, datë 24.09.2019, për licencimin e shoqërisë “AYEN AS ENERGJI” sh.a., në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike dhe nr. 141, datë 24.09.2019 mbi licencimin e shoqërisë “AYEN AS ENERGJI” sh.a., në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.

Konstatohet se:

- Me Vendimin nr. 141 datë 24.09.2019, Bordi i ERE-s ka vendosur në pikën 2: Të licencojë shoqërinë “AYEN AS ENERGJI” sh.a., në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, për një afat 5 - vjeçar, me kusht që të depozitohet në ERE vërtetimin për përfundimin e procedurës së apelimit për detyrimin e TVSH-së, ndaj Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve Tiranë.
- Në vijim të kësaj vendimmarrje, ERE i është drejtuar shoqërisë me shkresën nr. 520 Prot, datë 24.02.2020, për të marrë informacion në lidhje me ecurinë e plotësimit të kushtit të vendosur në pikën 2 të vendimit të sipërcituar.
- Shoqëria ka kthyer përgjigje me shkresën nr. 014 prot., datë 28.02.2020, protokolluar në ERE me nr. 520/1 prot., datë 02.03.2020, bashkëlidhur së cilës ka depozituar në ERE Shkresën nr. 1481/1 prot, datë 26.02.2020 të lëshuar nga Drejtoria e Tatimpaguesve të Mëdhenj, drejtuar shoqërisë “Ayen AS Energji” sh.a, nga e cila

rezulton se shoqëria nuk ka detyrime të pa likujduara për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar.

- *Sa më sipër, rezulton se shoqëria “Ayen AS Energji” sh.a, ka plotësuar kushtin e vendosur në pikën 2 të vendimitin e bordit të ERE nr.141 datë 24.09.2019.*

Për gjithë sa më sipër cituar, bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Në vendimin e bordit të ERE nr.141 datë 24.09.2019 “Mbi licencimin e shoqërisë “Ayen AS Energji” sh.a., në veprimtarinë e tregimit të energjisë elektrike” bëhet ndryshimi si më poshtë:
 - a. Pika 2 shfuqizohet.
2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikqyrjes, të njoftojë palën e interesit lidhur me vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim në ERE brenda 7 ditëve kalendarike si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE

Petrit AHMETI